

Opinion i Institutit te Medias lidhur me Projektligjin mbi Transmetimet Dixhitale, paraqitur ne Komisionin Parlamentar te Medias, me 24 Maj 2007

Te nderuar zoterinj deputete,

Ju falenderojme per ftesen per te ardhur dhe paraqitur ne kete Komision pikepamjet tona rreth Draftit te Ligjit per Transmetimet Digitale dhe komentet e BE dhe KE.

Ne kemi ndjekur nga afer, por edhe nga nje distance e nevojeshme, debatet e zhvilluara. Pikepamja jone eshte se ky proces dialogu, sadoqe i veshtire, ka qene i dobishem. Ajo qe ne verejme eshte **se ndersa Drafti i pare paraqiste disa pikepyetje serioze per lirine e shprehjes dhe permbushjen e standarteve nderkombetare ne kete fushe, drafti i ri, sikurse e konstatojne edhe Memorandumi i Zyres se Shtypit per Lirine e Shprehjes se OSBE ne Viene ashtu edhe ekspertet e BE ne pergjithesi i permbush standartet nderkombetare.**

**Tani mendojme se ceshtja shtrohet ne harmonizimin e standarteve nderkombetare me realitetin mediatik shqiptar.** Kjo eshte per mendimin tim ceshtja kryesore dhe kjo eshte edhe fusha ku duhet kerkuar konsensusi i te gjitha paleve.

Perpara kemi disa veshtiresi qe duhen mbajtur parasysh:

E para, **se ky Ligj po hartohet ne kushtet kur ne ende nuk kemi miratuar Strategjine e Kalimit ne Digital, qe perben tani nje nevoje urgjente.** Ne ende nuk dime afatet kur do te jete kycur analogu dhe gjithcka do te jete digitale. Do te ishte me e preferueshme qe te shkohej nga Strategjia tek Ligji dhe jo e kunderta.

Nje problem tjetër qe duhet mbajtur parasysh eshte **kompatibiliteti** i ketij Ligji me Ligjin ne fuqi te Medias Elektronike, i cili gjithashtu shpresojme te rishikohet se shpejti. Eshte e nevojeshme qe te dy ligjet te harmonizohen me njeri tjetrin dhe te mos shkojne kunder njeri tjetrit.

Nga ana tjetër, ne e kuptojme se ka argumenta qe shkojne **ne favor** te miratimit te Ligjit sa me pare, sidomos argumenta qe lidhen me **mbrojtjen e konsumatorit**, i cili, sikurse e kemi pare, ne kushtet e vakuimit ligjor ne me shume se nje rast eshte marre neper kembe. Sigurisht, edhe vete ata qe investojne ne kete fushe, jane te interesuar te veprojne ne nje **teren legal**, pasi keshtu do te ndiehen me te sigurte.

Lidhur me ceshtjen e frekuencave qe do t'i rezervohen transmetuesit publik. Pavaresisht nga verejtjet qe kane paraqitur operatorët private, eshte e qarte se eshte kthyer ne nje praktike te njohur tashme fakti se transmetuesit publik i ofrohet nje pozite e privilegjuar, si duke i rezervuar dy frekuenca, ashtu edhe duke aplikuar statusin “must-carry” ne rrjetet e tjere digitale.

Por, eshte urgjente qe **RTSH te paraqese urgjentisht strategjine e kalimit ne digital**, pasi do te ishte pa kuptim qe per nje periudhe prej 5 ose 7 vjecare, ne e mbanim te vdekura dy frekuencat qe normalisht i rezervohen transmetuesit publik.

Padyshim pika me ndieshme eshte ajo qe lidhet me garantimin e pluralizmit edhe ne fushen e transmetimeve digitale.

**Pikepamja e jone eshte se ndersa monopolet jane te papranueshme ne nje treg ku pluralizmi eshte shtylla dhe principi baze, gjithashtu edhe egalitarizmi dhe fragmentarizmi ekstrem do te ishte kontraproduktiv.**

Te jemi te ndergjegjshem, ne nuk po shkruajme nje ligj mbi nje tabula rassa. Duke shkruar kete Ligj ligjvenesit shqiptare synojne te rregullojne nje nga tregjet me te zhvilluar ne Europe ne fushen e transmetimeve digitale. Shqiperia ka nje penetrim te TV digital ne nivelet e Britanise, Gjermanise, Spanjes etj. **Prandaj do te ishte e aresyeshme qe te tregohet fleksibiliteti i nevojshem per te hartuar nje Ligj qe nuk ia mbyll deren gares dhe konkuresces, por qe respekton ne nje mase te aresyeshme, pa cenuar principet demokratike, edhe investimet e kryera** Une mendoj se Autoriteti i Konkuresces do te duhet te jape opinionin e tij ne kete aspekt.

Me ne fund, pasi kam konsultuar versionin shqip dhe anglisht te verejtjeve te Komisionit European, do te sugjeroja qe Komisioni t'i referohet origjinalit anglisht, pasi perkthimi i paraqitur ka disa pasaktesi serioze, qe mund te cojne ne konfuzion.

Ju faleminderit

Remzi Lani  
Drejtore i Institutit te Medias